



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Prot. 214 Nr.

Durrës, më 28/09/2023

V E N D I M

Nr. 22, datë 28/09/2023

"PËR HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK TË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, Vendimit të Senatit Akademik Nr. 52 datë 11.09.2023 "Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF)", Urdhërit të Rektorit nr.343, datë 27.09.2023 "Shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Komisionit të Integritetit akademik të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit të aplikimeve për anëtar të Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF) në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Regjistrimi i kandidatëve do të zhvillohet nga data **02.10.2023** deri në datën **06.10.2023**, orari **08.00 - 16.00**, pranë sekretarisë KIZ salla 303, Godina Currila.
3. Bashkëlidhur vendimit dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim.
4. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë **27.10.2023**.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK
TË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur më ____/____/____, në
_____, të rrethit _____, gjinia _____, staf akademik në
Departamentin _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
kandiduar si anëtar i Komisionit të Integritetit akademik të Fakultetit të Biznesit në Universitetin
"Aleksandër Moisiu" Durrës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për
ndonjë vepër penale.
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr, 136/2015 "Për garantimin e integritetit
të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për
dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e
titullit _____ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e
lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të
Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e KZF _____, (firma)



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Dokumentacioni për kandidim;

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarim për integritetin e lartë akademik të kandidatit
- c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) Kopje të noterizuar të titullit akademik, gradës shkencor edhe diplomës/diplomave të arsimit të lartë;
- g) Fotokopje të noteruar të librezës së punës.(Vërtetimi i punës)